



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 64, datë 28.12.2020

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT DHE PIKËZIMIT TË
KANDIDATURËS SË ZOTIT ALTIN BINAJ, PËR GJYQTAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 22.11.2019.**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Fiona Papajorgji	- Anëtare
Arta Marku	- Anëtare
Miranda Andoni	- Anëtare
Saida Dollani	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare

Asistuar nga sekretare **Vilma Dokushi**.

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës **28.12.2020**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDAT PËR GJYQTAR
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:** **Z. Altin Binaj**

OBJEKTI: Për përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturës së **z. Altin Binaj**, në vend vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur Presidenti i Republikës në datën **22.11.2019**.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoji relatimin e anëtarëve relatorë të Këshillit, **znj. Miranda Andoni**, mendimin e paraqitur nga **Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 25, datë 16.09.2020 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Altin Binaj për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Muçi.

2. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 dhe të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “*Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, anëtarja e Këshillit, znj. Miranda Andoni, në cilësinë e relatorit të vendit vakante përkatësisht të treguar në pikat 1 të këtij Vendimi, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.

3. Gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, konstatohet se në lidhje me kandidatin Altin Binaj me vendimin Nr. 77/2020, datë 17.12.2020 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka vendosur: “Zoti Altin Binaj zgjidhet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.”.

4. Në datën 22.12.2020, ora 12:30 zoti Altin Binaj ka bërë betimin përpara Presidentit të Republikës si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. Pas betimit, në përputhje me nenin 129 të Kushtetutës, ky gjyqtar do të fillojë ushtrimin e detyrës së tij.

5. Me Deklaratën e datës 22.12.2020, pas bërjes së betimit, zoti Altin Binaj ka deklaruar heqjen dorë nga kandidimi për vakancën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

6. Ligji nr. 8577/2000 dhe ligji nr. 115/2016 nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në raste të tilla.

7. Por, nga ana tjetër, ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se:

“2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.”.

8. Anëtari i Këshillit relator për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, ka përgatitur relacionin e vlerësimit të kandidatit ku është përshkruar edhe procedura e zhvilluar deri në këtë moment, si dhe projektaktin përkatës mbi përfundimin e procedurës administrative të vlerësimit të kandidatit Altin Binaj për këtë vakancë, duke njoftuar Këshillin lidhur me vullnetin e shprehur nga ky kandidat.

9. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga anëtari i Këshillit relator i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, si edhe në vetë formën e shprehjes së vullnetit nga kandidati në shqyrtim lidhur me vijimin e procedurave për vijimin e procedurave të vlerësimit dhe pikëzimit të këtij kandidati, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit Altin Binaj.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 125 dhe të pikës 1 dhe të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 dhe 3 të nenit 229 dhe të nenit 239/2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të zotit Altin Binaj, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Altin Binaj.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVËNDËSKRYETARË

Vitore TUSHA

